



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 21 prot.

Tiranë, më 06. 01. 2022

V E N D I M

Nr. 4, datë 06. 01. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 186, datë 13.10.2021, të S. S., ku pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”, nga ana e Drejtorisë së shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, Vau i Dejës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, pretendon se nga ana e ish-drejtorit dhe drejtorit aktual të shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, Vau i Dejës, prej 3 vitesh nuk trajtohet në mënyrë të barabartë me kolegët e saj, sa i përket ndarjes së ngarkesës mësimore. Sipas saj, ky veprim i tyre ka ardhur për shkak se ajo është emëruar e fundit në këtë shkollë, në raport me kolegët e saj.

Ankuesja pretendon se, në shkelje të Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kolegët e saj janë favorizuar në ndarjen e orëve të ciklit 9-vjeçar të profilit Matematikë. Nga 58 orë: 28 orë Matematikë, 13 orë Fizikë, 10 orë TIK, 6 orë kujdestari dhe 1 orë Aftësim Teknologjik, drejtori i shkollës në fillim të vitit shkollor 2021-2022 i ka shpërndarë orët si më poshtë:

¹ Për shkak se ankuesja pretendon se është emëruar e fundit në këtë shkollë.

- a) njëra prej mësueseve të Matematikës ka marrë: 16 orë Matematikë, 2 orë TIK, 2 orë kujdestari
- b) mësuesja tjetër e Matematikë-Fizikës ka marrë: 8 orë Matematikë, 1 orë Aftësim, 2 orë kujdestari dhe 9 orë Fizikë
- c) ankuesja, mësuese e Matematikës, ka marrë: 4 orë Matematikë dhe 6 orë TIK.

Përsa më sipër, ankuesja thekson se nga ana e drejtorit të shkollës, jo vetëm që nuk janë ndarë orët e profilit në mënyrë të barabartë me koleget e saj, por në ndryshim prej saj, ata janë plotësuar me ngarkesë të plotë mësimore (20 orë/javë), si dhe janë sistemuar me orë në profilet e tyre përkatëse.

Në këtë kuptim, ankuesja kërkon nga Komisioneri, të vërë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë (DRAP) dhe Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vau i Dejës (ZVAP), lidhur me trajtimin e pabarabartë të saj, si dhe të konstatojë situatën diskriminuese.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me vendbanimin, pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues (neni 1³). Neni 3, i këtij ligji, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në Kreun II, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me **çdo shkak tjetër.**”

⁴ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të LMD-së, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1439/1 prot., datë 21.10.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁵ Drejtorisë së shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, Vau i Dejës, lidhur me pretendimet e ankueses.

Në përgjigje përsa më sipër, Drejtoria e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, Vau i Dejës, me anë të shkresës⁶ nr. 42 prot., datë 02.11.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...1- Ngarkesa mësimore për vitin mësimor 2021-2022 është bërë në përputhje me Ligjet në fuqi për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, për S. S. dhe për mësuesit e profilit Matematikë, në ciklin AMU në SHMB “Imzot Luçjan Avgostini”. Në SHMB “Imzot Luçjan Avgostini” në ciklin AMU janë: 28 orë Matematikë, 13 orë Fizikë, 10 TIK dhe 1 orë Aftësim Teknologjik, pra 52 orë total.

Në mbështetje të Nenit 42 dhe Nenit 43, pika 2, germa b), c), ç), të Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore

ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”

⁵ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Informacion lidhur me normën mësimore për secilin nga mësuesit e profilit Matematikë dhe Matematikë-Fizikë të shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, për vitet shkollore 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022.
- Informacion lidhur me kriteret me anë të të cilave bëhet shpërndarja e ngarkesës mësimore.
- Informacion dhe kopje të procedurës, nëse është ndjekur ndonjë proces vlerësimi/konsultimi për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për mësuesit e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” në tërësi dhe ata të matematikës në veçanti.
- Informacion dhe kopje të vlerësimeve të punës së ankueses dhe kolegëve të saj të profilit Matematikë dhe Matematikë-Fizikë për 3 vitet shkollore.
- Informacion, sa i përket vjetërsisë në punë të mësuesve të profilit Matematikë dhe Matematikë-Fizikë.
- Kopje të kontratave të punës, kualifikimeve etj, për ankuesen dhe mësuesit e profilit Matematikë dhe Matematikë-Fizikë.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1439/2 prot., datë 08.11.2021

parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, dhe për arsye të mos gjetjes së mirëkuptimit dhe kompromisit në ciklin AMU në profilin Matematikë dhe Matematikë-Fizikë të mësuesve S. Q., S. S. dhe M. K. në ndarjen e orëve, me datë 18.10.2021 mësueses S. S. i është komunikuar nga drejtori i shkollës norma përfundimtare dhe është bërë shpërndarja e orëve si vijon:

1. S. Q.: 16 orë Matematikë, 2 orë SHQK dhe 2 orë kujdestari;
2. S. S.: 8 orë Matematikë, 10 orë TIK dhe 2 orë detyra shtëpie;
3. M. K.: 4 orë Matematikë, 13 orë Fizikë, 1 orë Aftësim Teknologjik dhe 2 orë Kujdestari.

Për arsye se:

- Znj. M. K. me diplomë Matematikë-Fizikë, me 25 vite punë në arsim dhe me Kategorinë e I (parë) të Kualifikimit në lëndën e Matematikës
- S. S. është emëruar në SHMB “Imzot Luçjan Avgostini” si mësuese definitive e lëndëve Matematikë, Fizikë dhe TIK, dhe nisur nga kjo i kemi dhënë 10 orë TIK, pra më shumë orë TIK sesa mësuesve të tjerë.

Është bërë shpërndarja e ngarkesës mësimore si më lart.

2- Ndarjen e ngarkesës mësimore, caktimin e mësuesit kujdestar dhe hartimin e orarit i cakton drejtori i shkollës, siç cilësohet edhe në Nenin 43 të Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, pika 2 ku thuhet “Drejtori pas këshillimit me këshillin e mësuesve”;

b) cakton ngarkesën mësimore të mësuesve dhe merr miratimin e ZVA për këtë çështje;

c) cakton mësuesit kujdestarë;

ç) harton orarin mësimor javor të institucionit, ose ngarkon një nëndrejtor ose mësues për hartimin e këtij orari;

3- Me datë 20.10.2021, grupi i inspektimit i ngritur sipas Urdhërit të drejtorit të DRAP Lezhë, ka zhvilluar një inspektim në SHMB “Imzot Luçjan Avgostini”, për verifikimin e ankesës së S. S. për ndarjen jo të drejtë të ankesës mësimore. Pas verifikimeve të bëra nga grupi i inspektimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë ka dalë në konkluzionin se është zbatuar Urdhëri Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” neni 43, pika 2/b e kësaj rregulloreje.

4- Vlen për tu theksuar së në vitin mësimor 2019-2020 që ka qenë edhe viti i parë i punës në SHMB “Imzot Luçjan Avgostini”, për S. S. është bërë ndarja e ngarkesës mësimore: 8 orë Fizikë, 8 orë TIK, 2 orë Aftësim Teknologjik dhe 2 orë Kujdestari. Dhe nga kjo ndarje e ngarkesës mësuesja në fjalë është ankuar në DRAP Lezhë dhe drejtori i shkollës i ka kthyer përgjigjen me email për sqarimet e nevojshme. Pra, nga sa u tha më sipër ju sqarojmë me përgjegjësi të plotë se ndaj mësuese S. S. nuk është përdorur asnjë lloj diskriminimi që pretendohet nga ana e saj...”.

2. Me e-mailin dt. 28.10.2021, nga ana e ankueses, u informua Komisioneri, duke prapësuar ndër të tjera se:

“...Ka pasur një reagim vetëm për një pikë nga DRAP Lezhë, sepse ankesa ime në fillim ka qenë e fokusuar në dy pika kryesore, ku vetëm një pikë është përmirësuar, sepse ngarkesën mësimore do e plotësoj tashmë në shkollën ku punoj dhe jo në shkolla të tjera siç më kishte urdhëruar drejtori i shkollës (ku e kam cituar edhe në ankesën e parë).

Pika e dytë nuk është zgjidhur akoma sepse kam kërkuar që orët e profilit matematikë të ndahen në mënyrë të barabartë mes dy mësuesve me diplomë Matematikë.

Nga mbledhja me DRAP Lezhë të dt. 20.10.2021, mu caktuan 8 orë matematikë dhe mësueses tjetër 20 orë matematikë dhe kjo rishpërndarje e re nga ana e tyre është në shkelje të ligjit/udhëzimit nr. 30, dt. 12.09.2018.

Pas mbledhjes së zhvilluar, me dt. 22.10.2021 vjen dhe përgjigjja nga DRAP Lezhë, ku përgjigjja e tyre nuk mbështet në asnjë kriter ligjor, sepse në pikën që ishin referuar më rikujton mua detyrat e drejtorit të shkollës (kjo pikë e marrë nga Rregullorja e Institucioneve Arsimore Parauniversitare) dhe kjo pikë ku janë mbështetur, nuk e hedh poshtë pretendimin e ankesës time që orët nuk ndahen sipas ligjit.

Nga raportet e institucioneve arsimore që përcillen me shkrim nuk pasqyrohet realiteti, sepse ndryshe shkruhet dhe ndryshe veprohet. P.sh.: sot mësuesja Matematikë-Fizikë, M. K. jep 4 orë matematikë në klasën e 6-të sepse nuk i takon sipas ligjit asnjë orë matematikë të japë mësim përpara meje dhe mësueses tjetër të profilit Matematikë...

Këto orë matematikë që jep sot mësuesja me diplomë Matematikë-Fizikë, sipas versionit të drejtorit të shkollës, pohon se kanë bërë marrëveshje dy mësueset dhe jam pro kësaj marrëveshjeje (mësuesja e Matematikës S. Q. i ka falur 4 orët mësuese M. K.).

Kjo marrëveshje është e kundraligjshme, sepse ndaj meje më hiqen orët e matematikës duke përdorur kriteret e pikëzimit (të marra nga një udhëzim tjetër që është shkelje ligjore), ndërsa nga ana tjetër drejtori lejon marrëveshjen mes dy mësuesve të tjerë ku kjo mësuese i merr orët e matematikës pa kritere pikëzimi.

Edhe pse rishpërndarja e re e orëve konsiderohet përsëri antiligjore dhe thyerje të kodit të etikës, ajo që e thellon më tepër shkeljen nga ana e drejtorit është se janë përdorur dy standarte (të pabazuara në ligj) për të njëjtën situatë, sepse drejtori i shkollës:

a) Me mua përdor kritere vlerësimi të pabazuar në udhëzimin 30, dt. 12.09.2018 dhe mi heq orët e matematikës që më takojnë.

b) Ndërsa paralelisht nga ana tjetër mësuesja M. K. (me diplomë Matematikë-Fizikë) i merr orët të dhuruara nga mësuesja tjetër pa kritere vlerësimi, si me qenë orët e tyre pronë private.

Konkluzioni im pas përgjigjes së marrë nga DRAP Lezhë:

Nuk do të jem aspak dakord me përgjigjen e tyre (DRAP Lezhë), pasi do të vazhdoj përsëri ankesën time të radhës në institucionet përgjegjëse deri në zbatimin e udhëzimit 30, dt. 12.09.2018.

Në përfundim:

Kërkoj nga institucioni Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të më mbështesë në zbatimin e ligjit nga institucionet e arsimit, ku orët e matematikës të ndahen në mënyrë të barabartë me mësuesen tjetër të matematikës.

Detaj shitesë: Vjet në muajin janar departamenti i Matematikë-Fizikë i janë drejtuar portalit të bashkëqeverisjes me një ankesë për të më larguar nga puna. Po të njëjtën ankesë me në krye mësuese M. K., kanë bërë edhe sot, nga fakti se jam emëruar në këtë shkollë sepse e konsiderojnë shkollën dhe orët si pronë private të tyre....”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, me Vendimin Nr. 45, datë 07.01.2019 dhe Kontratës Individuale të Punës (periudhë prove), ankuesja është emëruar mësuese me kontratë prove 1-vjeçare në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” Vau i Dejës. Sipas kontratës së punës, ankuesja ka pranuar të punojë mësuese e lëndës Matematikë-Fizikë-TIK.

Pas periudhës 1-vjeçare të provës, me Urdhër Nr. 58, datë 22.01.2020, ankuesja është emëruar mësuese definitive në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” Vau i Dejës, për lëndët Matematikë-Fizikë-TIK.

Nga provat e vëna në dispozicion nga palët, rezulton se:

Me emërimin në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, me kontratë prove 1-vjeçare, në vitin 2019, ankueses i është dhënë një ngarkesë mësimore në profil të përafërt: 8 orë Fizikë, 8 orë TIK dhe 2 orë Aftësim Teknologjik. Më datë 16.09.2019, ankuesja i është drejtuar me shkresë në portalin www.shqiperiaqeduam.al duke paraqitur një ankesë sa i përket ndarjes së orëve. Në ankesën e paraqitur në këtë portal, ankuesja ka parashtruar se nga ana e drejtorit të shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” Vau i Dejës, ishte bërë një ndarje e pabarabartë e orëve të profilit Matematikë. Sipas saj, mësueseve të tjera të këtij profili i ishte shpërndarë e gjithë ngarkesa e matematikës, duke lënë ankuesen pas asnjë orë në këtë profil.

Pas shqyrtimit të rastit nga Zyra e Bashkëqeverisjes⁷, ankueses i është kthyer përgjigje me e-mail më datë 30.09.2021, duke i sqaruar ndër të tjera se: “Nga rënia e numrit të nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2019-2020 janë mbyllur 2 klasa në AML⁸, një klasë e X dhe një klasë e XII, pra 8 orë më pak orë Matematikë në AML, të cilat do ishin pjesë e planifikimit për ngarkesën e mësuesve të profilit Matematikë dhe sigurisht dhe orë për S. S. Në këto kushte, drejtori shkollës meqënëse nuk ka realizuar procedurën sipas kreut 7, pika 9 të udhëzimit nr. 13 datë 22.05.2019, është detyruar të riorganizojë ngarkesën mësimore duke mos realizuar

⁷ Portali www.shqiperiaqeduam.al

⁸ Referuar Nenit 2 të Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, AML-shkurtim i Arsimit Mesëm i Lartë.

procedurën e largimit të asnjërit prej mësuesve të këtij profili, ku nga kjo ndarje e ngarkesës mësimore rezultojnë që për S. S. të ketë në dispozicion: 8 orë fizikë, 8 orë TIK, 2 orë A. teknologjik, me orë në profil të përafërt në një kohë që lëndet e profilit janë dhënë mësuesve me kontratë definitive. U kontaktua me drejtorin e shkollës dhe pas vlerësimit të kesaj situatë dhe ankesës së S. S., u vendos rishikimi i ndarjes së ngarkesës së mësuesve të këtij profili duke konsultuar edhe një herë këtë ngarkesë me departamentin lëndor për zgjidhje në favor të kërkesës së S. S. dhe në zbatim të udhëzimit MASR”.

Pra, nga informacioni i administruar dhe i vënë në dispozicion nga palët, rezultojnë se gjatë vitit shkollor 2019-2020, ankuesja ka patur një ngarkesë mësimore: 8 orë Fizikë, 8 orë TIK, 2 orë Aftësim Teknologjik dhe 2 orë Kujdestari.

Në fillim vitin shkollor 2020-2021, rezultojnë se mësuesve të profilit Matematikë-Fizikë i është caktuar nga ana e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” ngarkesa mësimore si më poshtë:

- S. S. - 4 orë Matematikë, 8 orë Aftësim Teknologjik, 6 orë Shkolla si Qendër Komunitare dhe 2 orë Kujdestari;
- M. K. - 8 orë Matematikë, 10 orë Fizikë dhe 2 orë Kujdestari;
- S. Q. - 16 orë Matematikë, 2 orë TIK dhe 2 orë Kujdestari.

Referuar shkresës nr. 3210/1 prot., datë 22.10.2021, të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, evidentohet se ankuesja ka kërkuar në rrugë zyrtare të verifikohet ngarkesa mësimore dhe ndarja e saj, në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”. Në përmbajtje të shkresës, rezultojnë se më datë 18.10.2020, nga ana e drejtorit të shkollës, është rishikuar ngarkesa mësimore e ankueses, si dhe është miratuar nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vau i Dejës, duke i caktuar: 8 orë Matematikë, 10 orë TIK dhe 2 orë Bëjmë Detyrat e Shtëpisë.

Në vitin shkollor 2021-2022, pas ankuesave të paraqitura nga ana e S. S., referuar shkresës nr. 21/8 prot., datë 30.06.2021, drejtoria e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, ka mbledhur Komisionin e Vlerësimit⁹, i cili ka vlerësuar me sistem pikëzimi, mësueset e profilit Matematikë-Fizikë, si më poshtë:

Emri	Profili	Nota mesatar e Diploma	Vitet e punës	Shkalla e kual.	Gjuhë e huaj (nëse ka)	Certif. trajnimi	Vlerësim i Drejtorit	Vlerësimi i Psikologut	Vlerësimi i Prindërve	Totali i pikëve
M. K.	Mat.-	1	13	9	-	3	2	2	2	32

⁹ Të përbërë nga: drejtori i shkollës dhe mësueset V. P. dhe B. K.

	Fizikë									
S. Q.	Mat.	2	7	6	2	3	2	2	2	26
S. Stankaj	Mat.	2	5	3	2	3	2	2	2	21

Pra pas ankesës, verifikimit të bërë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe vlerësimit të sipërcituar, rezulton se ankueses dhe mësuesve të profilit Matematikë-Fizikë, i është caktuar ngarkesa mësimore për vitin shkollor 2021-2022, si më poshtë:

- S. S. - 8 orë Matematikë, 10 orë TIK dhe 2 orë Bëjmë Detyrat e Shtëpisë;
- M. K. - 4 orë Matematikë, 13 orë Fizikë, 1 orë Aftësim Teknologjik dhe 2 orë Kujdestari;
- S. Q. - 16 orë Matematikë, 2 orë Shkolla si Qendër Komunitare dhe 2 orë Kujdestari.

Në Nenin 43, pika 2, të Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Drejtori pas këshillimit me këshillin e mësuesve”;

- a) *Vendos formimin dhe ndarjen e klasave dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë ndarje, bazuar në udhëzimin përkatës të ministrisë;*
- b) *cakton ngarkesën mësimore të mësuesve dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë çështje;*
- c) *cakton mësuesit kujdestarë;*
- ç) *harton orarin mësimor javor të institucionit, ose ngarkon një nëndrejtor ose mësues për hartimin e këtij orari;*

Në Kreun II/D të Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, përcaktohet norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve. Në pikën D/3, përcaktohet se: “Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë.”

Në Kreun V të Udhëzimit, citohet se: “1. Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij. Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, ai ngarkohet me orë të profileve të përtafërta, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij Udhëzimi....

2....

3....

4....

9. *Puna e mësuesit kujdestar në shkollat e arsimit parauniversitar barasvlerësohet me 2 orë mësimore në javë... ”.*

Pika 3 e Shtojcës bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në

institucionet e arsimit parauniversitar”, përcaktohen mësuesit sipas profileve, për arsimin e mesëm të ulët:

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe-letërsi	
2.	Gjuhë e huaj	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	Gjuhë e huaj: e mesme e gjuhëve të huaja e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)
3.	Matematikë	Matematikë	Matematikë-Fizikë
4.	Fizikë	Fizikë	Matematikë-Fizikë
5.	Kimi	Kimi	Bio-Kimi, Biologji
6.	Biologji	Biologji	Bio-Kimi, Kimi
7.	Histori	Histori	Histori- Gjeografi, Histori
8.	Gjeografi	Gjeografi	Histori- Gjeografi, Gjeografi
9.	Qytetari	Shkenca sociale	Histori- Gjeografi, Histori, gjeografi, gjuhë shqipe-letërsi
10.	Art pamor	Arte figurative	E mesme artistike e profilizuar për mësuesi, shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)
11.	Muzikë	Arte muzikore	E mesme e muzikës e profilizuar për mësuesi, shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)
12.	Kërcim	Arti skenik (koreografi)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose edukim fizik
13.	Teatër	Arti skenik (aktrim, regji)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose gjuhë shqipe
14.	Aftësim teknologjik	Shkencat e natyrës, TIK,	Shkencat e natyrës, Informatikë
15.	Edukim fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim Fizik	Mësues i fizkulturës shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar)
16.	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë, Fizikë

Në analizë të informacionit dhe provave të administruara, rezulton se ankuesja që në momentin e emërimit në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, ka kërkuar që nga ana e drejtorit të shkollës të bëhet një ndarje e barabartë e ngarkesës mësimore të orëve të profilit të

matematikës. Nga ana e drejtorisë së shkollës, referuar ankesave të S. S., janë kryer disa herë mbledhje të këshillit¹⁰ të mësuesve gjatë vitit 2019-2020-2021 dhe është rënë dakord me ndarjen e orëve të profilit Matematikë-Fizikë, sipas ngarkesës së sipërcituar.

Në mbështetje të Urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Drejtori pas këshillimit me këshillin e mësuesve” dhe Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, Drejtori i shkollës ka ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e nevojshëm për ndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve të profilit Matematikë-Fizikë, ku bën pjesë edhe ankuesja. Një konstatim i tillë, rezulton të jetë bërë edhe nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, me anë të shkresës Nr. 3210/1 prot., datë 22.10.2021, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, referuar Raportit të Vlerësimit¹¹ me nr. 2175/3 prot., datë 13.12.2021.

Në Kreun 6, të Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, parashikohet në mënyrë të qartë rastet kur konsiderohet një pozicion i lirë pune për mësues. Më saktësisht përcaktohet se: “1. Vend i lirë pune do të konsiderohet çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, pavarësisht nëse është në një apo në disa institucione arsimore parauniversitare. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore parauniversitare, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore.

2. Punësimi në një vend të lirë pune më kohëzgjatje të pacaktuar duhet të ruajë vijimësinë e ngarkesës mësimore edhe për vitin shkollor pasardhës.
3. ZVAP-të në bashkëpunim me drejtoritë e IAL-vë publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike.”

Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit shkollor 2019-2020, në total ishin në dispozicion 32 orë në profilin Matematikë dhe 10 orë në profilin Fizikë. Në momentin e emërimit të ankueses në vitin 2019, në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, ishin të emëruara prej vitesh 2 mësuese, një e diplomuar në profilin Matematikë dhe një e diplomuar në profilin Matematikë-Fizikë.

Në analizë të parashikimeve ligjore të sipërcituara, konstatohet se për emërimin e një mësuesi të ri në një shkollë, duhet të ishin minimalisht 20 orë të lira pune në një profil. Në rastin e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, rezultoi se në profilin Matematikë apo Fizikë,

¹⁰ Sipas informacionit të dhënë nga subjekti ankues me e-mailin datë 21.10.2021

¹¹ Të vënë pjesërisht në dispozicion të Komisionerit nga ana e subjektit ankues me anë të e-mailit date 29.12.2021.

ishin në total 42 orë për mësueset e kësaj shkolle. Pra, rezultoi asnjëra prej mësueseve aktuale të shkollës nuk plotësohej me ngarkesën e plotë mësimore. Rrjedhimisht në këtë kuptim, në shkollën e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, nuk kishte orë të lira për emërimin e një mësuesi të ri të profilit Matematikë apo Fizikë. Megjithatë nga ana e drejtorisë së shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, është bërë emërimi i S. S., si mësuese e profilit Matematikë-Fizikë-TIK.

Në kushtet që me emërimin e S. S., nuk mund të mbuloheshin 3 mësueset me lëndë sipas profilit të tyre, u konstatua se mbështetur në parashikimet ligjore të sipërcituara, drejtoria e shkollës, bëri rishpërndarjen e ngarkesës mësimore, duke i caktuar secilës mësuese, veç lëndëve të profilit edhe lëndë të profileve të përafërta, për t’i plotësuar me ngarkesë të plotë mësimore.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, verifikimeve të bëra nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, rezultoi se Drejtori i shkollës ka ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e nevojshëm për plotësimin, si dhe ndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve të profilit Matematikë-Fizikë, ku bën pjesë edhe ankuesja.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për ankuesen dhe mësueset e tjera të profilit Matematikë/Fizikë;
- Ankuesja nuk është vendosur në asnjë moment në kushte të pafavorshme nga ana e drejtorisë së shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”.

Diskriminimi përkuftizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se shkolla e mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini”, për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankueses S. S., nga ana e shkollës së mesme të bashkuar “Imzot Luçjan Avgostini” Vau i Dejës, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)